



NJË PERSPEKTIVË E BESUESHME PËR ZGJERIM DHE ANGAZHIM TË SHTUAR TË BE-SË ME BALLKANIN PERËNDIMOR



GJASHTË NISMAT E REJA KYÇE PËR PËRKRAHJEN E TRANSFORMIMIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Përmes gjashtë nismave kyçe, Strategjia e Ballkanit Perëndimor përcakton përkrahjen e pashembullt të BE-së për procesin e transformimit në Ballkanin Perëndimor, duke synuar fushat specifike të interesit të dyanshëm për BE-në dhe vendet e Ballkanit Perëndimor:



NISMA PËR FORCIMIN E SUNDIMIT TË LIGJIT

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të zgjerohen mjetet ekzistuese, siç janë planet e detajuara të veprimit. Do të zgjerohet vlerësimi i zbatimit të reformave, duke përfshirë misionet e reja këshilluese. Do të përdoren më shumë mundësitë e ndikimit të siguruara në kornizat negociuese me Malin e Zi dhe Serbinë



NISMA PËR PËRFORCIMIN E ANGAZHIMIT PËR SIGURINË DHE MIGRIMIN

Bashkëpunim i përforcuar në luftimin e krimit të organizuar, luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për sigurimin e kufijve dhe menaxhimin e migracionit. Në rajon do të vendosen zyrtarët ndërlidhës të Europol-it; do të promovohen më tej Ekipet e Përbashkëta Hetimore dhe do të lidhen marrëveshjet e statusit me Agjencinë Evropiane të Rojeve Kufitare Bregdetare.



NISMA PËR ZGJERIMIN E PËRKRAHJES PËR ZHVILLIM SOCIO-EKONOMIK

Kjo do të përfshijë zgjerimin e Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor, nxitje të konsiderueshme në sigurimin e garancive për thithjen e investimeve private, përkrahje për biznese fillestare dhe NVM-të dhe lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë. Dimensioni i ri dhe i përforcuar social do të përqendrohet më shumë në punësimin dhe politikat sociale, përmes rritjes së ndihmës financiare në përkrahje të sektorit social, në veçanti në arsim dhe shëndetësi. Do të dyfishohet financimi sipas Erasmus +.



NISMA PËR RITJEN E NDËRLIDHSHMËRISË SË TRANSPORTIT DHE ENERGJISË

Brenda rajonit dhe BE-së, duke përfshirë përkrahjen e investimeve të reja. Në vendet e Ballkanit Perëndimor do të përdoret me më shumë efektivitet Instrumenti i Lidhjes së Evropës. Bashkimi Evropian i Energjisë duhet të zgjerohet në Ballkanin Perëndimor.



NISMA PËR AGJENDËN DIGJITALE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Kjo do të përfshijë një udhërrëfyes për të lehtësuar uljen e kostove të roamingut, përkrahje për vendosjen e broadband dhe zhvillimin e eQeverisjes, eProkurimit, eShëndetësisë dhe shkathtësive digjitale.



NISMA NË PËRKRAHJE TË PAJTIMIT DHE MARRËDHËNIEVE TË MIRA FQINJËSORE

Kjo do të përfshijë përkrahjen për drejtësinë tranzicionale dhe personat e zhdukur, rritjen e bashkëpunimit në arsim, kulturë, rini dhe sport dhe zgjerimin e fushëveprimit të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor. Ballkani Perëndimor do të jetë plotësisht i asociuar me Vitin Evropian të Trashëgimisë Kulturore; do të lansohet Rruga e trashëgimisë BE-Ballkani Perëndimor.